



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Prishtinë 18/05/2019

## Termet e referencës Ekspert të cilësisë së derivateve të naftës

### Qëllimi i angazhimit të ekspertit afatshkurtër të jashtëm

Zyra Kombëtare e Auditimit është në proces të auditimit të performancës “**Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve të naftës**”. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti të auditimit është vlerësimi i efektivitetit të aktiviteteve lidhur me kontrollin dhe monitorimin e cilësisë së derivateve të naftës para se këtij produkti ti miratohet hyrja në tregun e brendshëm dhe gjatë kohës që ky produkt është në qarkullim në tregun e brendshëm.

Për shkak të fushës dhe njohurive specifike që kërkohen për kryerjen e këtij auditimi, Zyra Kombëtare e Auditimit kërkon angazhimin e ekspertit të cilësisë së derivateve të naftës.

Kohëzgjatja e projektit është 10 ditë pune.

### Përshkrimi i punës dhe detyrat kryesore të Ekspertit të Cilësisë së Derivateve të Naftës

Eksperti i cilësisë së derivateve të naftës duhet të përkrahë ekipin e auditimit për pjesën e vlerësimit dhe interpretimit të parametrave të cilësisë së derivateve të naftës sipas kontrolleve që kryhen në import nga ana e Doganës së Kosovës dhe në treg të brendshëm që kryhen nga ana e Inspektoratit të Tregut (Ministri të Tregtisë dhe Industrisë).

Eksperti në veçanti duhet të përkrahë ekipin me udhëzimet dhe ekspertizën në interpretimin e parametrave të cilësisë së derivateve të përcaktuar me legjislacionin në fuqi si dhe rëndësisë që secili parametër ka për matjen e cilësisë së derivateve dhe ndikimit të këtyre parametrave në mjedis dhe automjete.

Eksperti po ashtu duhet të ofrojë ekspertizën në aspekt të ofrimit të praktikave të mira në kontrollin e cilësisë së derivateve dhe krahasimin e tyre me praktikën aktuale në vend.

Eksperti i cilësisë së derivateve të naftës ndër të tjera duhet të promovojë praktikat efikase duke rekomanduar përmirësime për mangësitë që identifikohe.

Ndër të tjera, përgjegjësi të ekspertit janë edhe:

- Të ofrojë ekspertizën e duhur lidhur me derivatet e naftës dhe interpretimin e parametrave të cilësisë së derivateve të naftës që do të sigurojmë nga laboratorët që bëjnë testimin e cilësisë së derivateve;
- Të vlerësojë dhe hartojë një raport mbi ndikimin mjedisor dhe ndikimet e tjera që ka cilësia e dobët e derivateve të naftës tek automjetet;
- Të kuptoj të gjitha procedurat e auditimit dhe duhet të ruaj pavarësinë e nevojshme për të kryer auditimin;

- Prezenca e ekspertit është e nevojshme gjatë fazës së ekzekutimit të auditimit;
- Letrat e punës duhet të përpilohen në bazë të standardit që aplikon ZKA po ashtu duhet siguruar dëshmi të mjaftueshme dhe relevante lidhur me të gjeturat dhe të gjitha dëshmitë duhet të jenë të dokumentuara;
- Të veprojë në përputhje me kodin e etikës që aplikohet në ZKA;
- Të jetë i gatshëm t'i përgjigjet kërkesave të tjera që mund të dalin nga faza e ekzekutimit (puna në teren) dhe që konsiderohen të nevojshme për nevoja të auditimit siç janë pjesëmarrja në takime me ekipin, me palët e audituara, si dhe komunikimi i vazhdueshëm me ekipin e auditimit.

### **Përgatitja e raportit**

Raporti i Ekspertizës do të fokusohet në prezantimin e të dhënave dhe analizave mbështetëse në një vëllim të veçantë, nëse është e nevojshme. Duhet të përfshijë një përmbledhje ekzekutive që diskuton shkurtimisht gjetjet e rëndësishme dhe veprimet e rekomanduara. Struktura e sugjeruar e raportit është e përshkruar më poshtë:

- Përmbledhja e përgjithshme;
- Qasja dhe metodologjia e përdorur;
- Politikat, ligjet, rregulloret, standardet;
- Analizat e kryera;
- Ndikimet potenciale mjedisore dhe në automjete;
- Konkluzionet dhe rekomandimet.

### **Kërkesat e punës**

Eksperti i cilësisë së derivateve të naftës duhet të ketë edukimin relevant, ku përparësi do tu jepet kandidatëve që kanë të përfunduar studimet Bachelor në drejtimet si Kimi, Inxhinieri Kimike, Shkenca Mjedisore dhe Gjeoshkenca.

Po ashtu është e preferueshme që eksperti të posedojë njohuri dhe trajnime adekuata në fushën e cilësisë së derivateve të naftës, specifikisht për standardin ISO/IEC 17025:2007 i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për kompetencën për të kryer testet dhe/ose kalibrimet, duke përfshirë marrjen e mostrave. Përparësi do tu jepet edhe kandidatëve që posedojnë njohuritë dhe ekspertizën e duhur për metodat e analizave të derivateve të naftës sipas standardeve: EN ISO 3405:2000, EN ISO 20846:2011, EN ISO 3104:1996.

Eksperti duhet të ketë 5 vite përvojë pune në fushën e cilësisë së derivateve të naftës apo të ngjashme.

Eksperti duhet të ketë njohuri rreth parametrave për matjen e cilësisë së derivateve të naftës, në veçanti të jetë i/e aftë të interpretojë vlerat e lejuara të përbërësve dhe treguesve të cilësisë së derivateve të naftës dhe rëndësisë që ato kanë në aspekt të cilësisë.

Kandidatët e interesuar duhet të bashkëngjisin këto dokumente:

- Letër Motivuese;
- Biografi (CV);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshminë për studimet universitare;
- Kopjet e trajnimeve relevante të kryera (nëse ka);
- Dëshmitë mbi përvojën e punës në fushën përkatëse; dhe
- Referencat apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatin që aplikon.